

**5 – 8 nëntor, 2007**  
**Prishtinë, UNMIK/Kosovo**

# **Biografitë e Instrukturëve**

**NARUC/ERRA Trajnimi mbi Rregullimin e  
Energjisë dhe Përpilimin e Tarifave**

*Organizuar nga NARUC dhe ERRA*

*Sponsorizuar nga USAID*

[www.naruc.org](http://www.naruc.org)

[www.erranet.org](http://www.erranet.org)



National  
Association of  
Regulatory  
Utility  
Commissioners



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



## BIOGRAFITË E INSTRUKTORËVE



### **JANKAUSKAS, VIDMANTAS**

*Ish kryesues i Komisionit Kombëtar të Kontrollit për Energji dhe Çmime, Lituani*

Dr. Vidmantas Jankauskas ka studiuar në Universitetin Vilnius dhe ka punuar për njëzet vite në Institutin e Energjisë së Lituanisë, në hulumtime të ekonomive energjetike. Ai doktoroi në vitin 1983 dhe fitoi diplomën dytë të doktoraturës (*doctor habilitation*) në vitin 1994. Që nga viti 1995, ai ishte profesor i ekonomisë në Universitetin Vilnius. Në shkurt të vitit 1997 u emërua nga Kryetari i Lituanisë si Kryesues i Komisionit Kombëtar të Kontrollit për Çmime dhe Energji, Rregullator i Pavarur i Energjisë. Në prill të vitit 2002, ai u riemërua në mandatin e tij të dytë pesëvjeçar. Vidmantas Jankauskas është anëtar i Asociacionit Ndërkombëtar për Ekonomi të Energjisë. Në mes të viteve 2002-2003, ai ishte Nën-kryesues i Asociacionit rajonal të rregullatorëve të energjisë dhe Kryesues i tij nga 2003 deri në 2005.



### **KADERJÁK, PÉTER**

*Drejtor i qendrës rajonale për hulumtim të politikave rajonale të energjisë (REKK), Budapest, Hungari*

Dr Péter Kaderják ishte kryetar i Zyrës hungareze të energjisë; Profesor në katedrën e mikroekonomisë në Universitetin Ekonomik të Budapestit; dhe ish Kryesues i Asociacionit rajonal të rregullatorëve të energjisë (ERRA). Z. Kaderják më herët ishte Kryesues i

kabinetit të ministrisë dhe Sekretar i Komisionit për ekonomi pranë qeverisë së Hungarisë. Nga 1998-1999, ai shërbeu si anëtar i bordit të drejtorëve të Privatizimit shtetëror dhe kompanisë së mbajtjes së aseteve. Para kësaj, ai ishte Këshilltar i lartë për politika mjedisore dhe anëtar i Grupit punues këshillëdhënës për politika në Institutin e Harvardit për zhvillim ndërkombëtar në Budapest. Ai shërbeu si Koordinator për projektin Phare-ACE, Implikimet mjedisore të ekonomisë në tranzicion në Hungari. Z. Kaderják filloi karrierën e tij në ekonomi si Ligjërues në katedrën e ekonomisë së biznesit në Universitetin ekonomik të Budapestit 1987. Ai mori pjesë në punëtori trajnuese në ShBA dhe Austri. Nga 1989-1990, ai ishte Asistent vizitues i hulumtimit i psikologjisë ekonomike në Universitetin Erasmus. Z. Kaderják është Anëtar i Asociacionit Evropian të ekonomistëve mjedisorë dhe të resurseve (EAERE) që nga 1993.

---



### **KOVÁCS, CSABA**

*Kryesues i departamentit për hulumtim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit,  
Zyra hungareze e energjisë (HEO)*

Z. Kovács diplomoi në ekonomi (specializoi në kontabilitet) në Universitetin e Budapestit të Shkencave ekonomike dhe administratë publike në vitin 2000. Atë vit ai iu bashkua Zyres hungareze të energjisë si analist ekonomik dhe punoi për Departamentin e licencimit elektrik. Një vit më vonë ai u bë anëtar i departamentit të sapo formuar të Zyres: Hulumtimi ekonomik dhe mbrojtja mjedisore. Ai ishte përgjegjës për zhvillimin e sistemit të monitorimit të performancës ekonomike të ndërmarrjeve të energjisë. Në nëntor të vitit 2003 ai u emërua si kryesues i departamentit dhe tani është i përfshirë në temat në vijim: llogaritja e tarifave, pagesat e bllokuara të kostos, çështjet e modelit të tregut, shthurja, tregtimi i emisionit, skemat përkrahëse të ripërtërishme.

---



**WITMER, JOSEPH K. ESQ.**

*Avokat III, Byroja ligjore, Komisioni i kompanive publike në Pensilvani, ShBA*

Z. Witmer ka punuar në sektorin e kompanive publike, me një fokus të veçantë në telekomunikim dhe energji në Massachusetts, Delaware dhe Pensilvani. Para hyrjes në sektorin e kompanive publike, z. Witmer ka punuar në ligjin mjedisor në një kompani ligjore dhe ishte instruktor në Kolegjin Universitar Verilindor për dhjetë vite. Gjatë kohës së kaluar në Universitetin Verilindor, z. Witmer specializoi në filozofinë politike dhe qeveritë komparative. Z. Witmer po ashtu zhvilloi studime shtesë për studentë të klasave të larta në temat si politikat e gjenocidit, rregullimi mjedisor dhe integrimi ekonomik i shteteve-kombëtare në baza rajonale.

Z. Witmer është me Komisionin e kompanive publike të Pensilvanisë që nga viti 1993. ai ka punuar në çështjet e kompanive publike në Zyrat e komisionit të asistentëve specialë (OSA) dhe aktualisht është me Byronë Ligjore. Ai më herët shërbeu si Këshilltar për Komisionerin Aaron Wilson, Jr. në Komisionin e kompanive publike të Pensilvanisë. Z. Witmer mori pjesë në prezantime të mëparshme ndërkombëtare të këmbimit mbi telekomunikimin dhe rregullimin e energjisë për delegacione tjera kombëtare përfshirë Indinë, Egjiptin dhe Azerbajxhanin.

Z. Witmer ndoqi Universitetin Susquehanna, Universitetin e Shkollës së Drejtësisë së Detroitit, Universitetin Verilindor dhe Universitetin e Harvardit. Ai jeton në Camp Hill, Pensilvani.

---



**HAKVOORT, R. A.**

*Partner, D-Cision B.V., Zwolle, Holandë*

Dr.ir. Rudi Hakvoort ka njohuri dhe përvojë të thellë në fushën e rregullimit të rrjetit të energjisë dhe funksionimit të tregut. Si asistent profesor në fakultetin e Teknologjisë,

Politikave dhe Menaxhmentit të Universitetit të Teknologjisë Delft, ai aktualisht studion dizajnin dhe organizimin e tregjeve të liberalizuara të energjisë. Nga 1998–2005, dr.ir. Hakvoort drejtoi departamentin e Tregut dhe Infrastrukturës së Zyrës holandeze të Rregullatorit të Energjisë ku ishte përgjegjës për cilësinë e rrjetit dhe zhvillimin e kapaciteteve, ndërlidhjet, menaxhmentit e mbingarkesës, dizajnin e tregut dhe zhvillimin e tregut, mbikëqyrjen e tregut dhe po ashtu për vendimin e vitit 2004 në emër të qeverisë holandeze për NorNed-cable, lidhjes elektrike 700 MW DC në mes të Holandës dhe Norvegjisë (që të autorizohet në vitin 2008).

Dr.ir. Hakvoort ishte kryesues i grupit punues për Menaxhim të mbingarkesës të Këshillit të Rregullatorëve Evropian të Energjisë (CEER) nga 2000–2004. Veç kësaj, dr.ir. Hakvoort është duke kontribuar në Shkollën e Firences së Rregullimit në Universitetin Evropian (Firence, Itali).

EKSPERTIZA KRYESORE:

Cilësia e rrjetit dhe rregullimi i cilësisë, shturja, veprimi i rrjetit, rregullimi i qasjes, zhvillimi i kapaciteteve, investimet, menaxhimi i mbingarkesës, dizajni i tregut, tregjet e vendit ato të balancimit, mbikëqyrja e tregut, rrjeti dhe kodet e sistemit, matja dhe zgjidhja.

---



### **BISLIMI, BESNIK**

*Profesor, Universiteti Amerikan në Kosovë*

Dr. Bislimi pranoi diplomën shkencore *bachelor* në Analiza makroekonomike në Fakultetin ekonomik në Zagreb në vitin 1994. Dr. Bislimi përfundoi doktoraturën e tij në ekonomi, me fokus në Financat publike në vendet në tranzicion në Universitetin teknik në Freiberg, Gjermani. Fushat e tij të interesit përfshijnë politikat tatimore, borxhet publike, decentralizimi, privatizimi, politikat e tregut të punës, politikat kundër korrupsionit.

Dr. Bislimi më herët ka mbajtur disa takime akademike në Universitetin e Freiberg dhe Universitetin e Prishtinës, Kosovë. Detyra të tjera të tij përfshijnë punë si ekspert ndërkombëtar i politikave tatimore për UNMIK (administrata ndërkombëtare e themeluar në Kosovë) dhe për UNDP; këshilltar i pavarur dhe udhëheqës i projekteve për Ministrinë e Shëndetësisë në Kosovë, Zyrën ndërlidhëse të Holandës në Kosovë, Iniciativën e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe Shërbime Botërore Universitare. Që nga viti 2004, Dr. Bislimi ligjëron Parimet e Ekonomisë, Financat publike dhe politikat monetare në Universitetin Amerikan në Kosovë.

Dr. Bislimi zotëron shpërblime të dalluara studentore nga Universiteti i Zagrebit dhe ka pranuar Bursën Fulbright për një hulumtim qëndrimi postdiplomik në Universitetin Shtetëror të Gjeorgjisë.

---

### ***Informatat kontaktuese të Instrukturëve të Kursit***

#### **Jankauskas, Vidmantas, Drejtor i kursit**

Ish Kryesues i Komisionit Kombëtar të Kontrollit për Energji dhe Çmime (NCC), Lituani  
Telefoni: +370 686 84139; E-mail: [vj0723@gmail.com](mailto:vj0723@gmail.com)

#### **Kaderják, Péter**

Drejtor i Qendrës rajonale për hulumtim të politikave të energjisë (REKK), Budapest, Hungari  
Telefoni: (36 1) 482-7071; Fax: (36 1) 482-7037; E-mail: [pkaderjak@uni-corvinus.hu](mailto:pkaderjak@uni-corvinus.hu)  
Internet: <http://www.rekk.eu>; <http://www.rekk.uni-corvinus.hu>

#### **Kovács, Csaba**

Kryesues i Departamentit për hulumtime ekonomike dhe mbrojtje mjedisore Zyra hungareze e energjisë (HEO), Hungari  
Telefoni: (36 1) 459 7781; E-mail: [kovacs@eh.gov.hu](mailto:kovacs@eh.gov.hu)  
Internet: <http://www.eh.gov.hu>

#### **Witmer, Joseph K., Esq.**

Asistent avokat, Byroja ligjore Komisioni i kompanive publike i Pensilvanisë (PA PUC)  
Telefoni: (1 717) 787-3663; E-mail: [jowitmer@state.pa.us](mailto:jowitmer@state.pa.us)  
Internet: <http://www.puc.state.pa.us>

#### **Hakvoort, R.A.**

Partner i D-Cision B.V., Zwolle, Holandë  
Telefoni: +31 6 55 348 308  
E-mail: [r.a.hakvoort@d-cision.nl](mailto:r.a.hakvoort@d-cision.nl); [r.a.hakvoort@filtnet.nl](mailto:r.a.hakvoort@filtnet.nl)

#### **Bislimi, Besnik**

Profesor i mikroekonomisë, makroekonomisë, financave publike, politikave dhe analizave monetare në Universitetin Amerikan në Kosovë  
Telefoni: +381 38 556 364; +377 44 102 001  
E-mail: [bbislimi@aukonline.org](mailto:bbislimi@aukonline.org)